Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.250/2026 http://kk.rks-gov.net/istog/
Data: 16.03.2026

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1.dhe 1.6 të rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025 i miratuar me datë 31.07.2025, Drejtoria për Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën 06-Nr.553-6149 të datës 26.02.2026 të parashtruar nga Hysni Tafilaj nga Rakoshi Komuna Istog, për përkrahje financiare për familjet dhe kategoritë me nevojë nënë vetushqyese dhe jeton në kushte të vështira socio-ekonomike dhe me procesverbal Nr.9/2026 i datës 13.03.2026, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 06Nr.553-6149 e datës 26.02.2026 e parashtruar nga Hysni Tafilaj për përkrahje financiare e cila jeton në kushte të vështira socio-ekonomike dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **pesëqind euro (500.00€)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.

2. Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Hysni Tafilaj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësive.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset:Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

4. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ në Gjukaten Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Hysni Tafilaj
- Drejtoria për Mirëqenie Sociale dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E ISTOGUT * OPSTINA ISTOG * REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.249/2026
Data: 16.03.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1.dhe 1.6 të rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025 i miratuar me datë 31.07.2025, Drejtoria për Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën 06-Nr.553-6198 të datës 26.02.2026 të parashtruar nga Antigone Sadriaj nga Cerkolezi Komuna Istog, për përkrahje financiare për familjet dhe kategoritë me nevojë nënë vetushqyese dhe jeton në kushte të vështira socio-ekonomike dhe me procesverbal Nr.10/2026 i datës 13.03.2026, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 06Nr.553-6198 e datës 26.02.2026 e parashtruar nga Antigone Sadriaj për përkrahje financiare e cila jeton në kushte të vështira socio-ekonomike dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **pesëqind euro (500.00€)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.

2. Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Antigone Sadriaj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësive.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset:Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

4. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ në Gjukaten Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Antigone Sadriaj
- Drejtoria për Mirëqenie Sociale dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E ISTOGUT * OPŠTINA ISTOG * REPUBLIKA KOSOVO

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 248/2026
Data: 16.03.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në Ligjin Nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe bazuar ne nenin 69 paragrafi 4 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010 i miratuar me datën 30.11.2010, shqyrtohet kërkesa 06Nr.2/2025 të datës 10.03.2026, e parashtruar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale për ndarjen e mjeteve buxhetore për pako ushqimore për familjet në nevojë, nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: Kërkesa 06Nr.2/2026 e datës 10.03.2026, e parashtruar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale, për ndarjen e mjeteve buxhetore për pako ushqimore për familjet në nevojë në shumë prej **5,900.00€ (pesë mijë e nëntëqind euro)** nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.

2. Mjetet e miratuara në pikën 1 të këtij vendimi do ti transferohen në xhirollogarinë e operatorit ekonomik me të cilin komuna ka kontratë të lidhur, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

4. Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:
-Drejtorisë për Mirëqenie Sociale,
-Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe
-Arkivi i zyrës së Kryetarit

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOG
REPUBLIKA KOSOVO

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr.247/2026
Data: 16.03.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës, bazuar ne Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne Nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1.dhe 1.6 të rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025 i miratuar me datë 31.07.2025, Drejtoria për Mirëqenie Sociale, shqyrtoi kërkesën 06-Nr.553-4926 të datës 11.02.2026 të parashtruar nga Fahmije Avdijaj nga Vrella Komuna Istog, për përkrahje financiare për familjet dhe kategoritë me nevojë nënë vetushqyese dhe jeton në kushte të vështira socio-ekonomike dhe me procesverbal Nr.11/2026 i datës 13.03.2026, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 06Nr.553-4926 e datës 11.02.2026 e parashtruar nga Fahmije Avdijaj për përkrahje financiare e cila jeton në kushte të vështira socio-ekonomike dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **pesëqind euro (500.00€)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale.

2. Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Fahmije Avdijaj në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësive.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset:Drejtoria për Mirëqenie Sociale.

4. Vendimi është përfundimtar.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të hap Konflikt Administrativ në Gjukaten Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Fahmije Avdijaj
- Drejtoria për Mirëqenie Sociale dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOK REPUBLIKA KOSOVO

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 246/2026
Data: 13.03.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, për themelimin e Komisionit permanent për verifikimin dhe pranimin e projekteve sipas kontratës: "Intervenimi emergjent në Palestrën e Sporteve-Punët Shtesë", dhe nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për verifikimin punimeve për projektin sipas kontratës: "Intervenimi emergjent në Palestrën e Sporteve-Punët Shtesë", me numër prokurimi 633-23-10084-5-1-1/C812, dhe 633-25-5441-5-2-5/C1004, të cilin projekt e ka realizuar operatori ekonomik **"UNICRON" Sh.P.K.** dhe në komision caktohen dhe në komision caktohen:

1.1. Alban Llapi, Kryesues i Komisionit;
1.2. Blerim Bujupi, anëtar;
1.3.Abedin Idrizaj, anëtar;

2. Komisioni i lartcekur do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekura në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejt të Menaxherit të kontratës; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e verifikimit te punimeve; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
- Komisionit,
- Menaxher i Projektit z.Bardhok Jetishi
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOK
REPUBLIKA KOSOVO

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr. 244/2026
Data: 16.03.2026

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), më qëllim të themelimit të Grupit Punues për plotësimin e Pyetësorit të Vetë Vlerësimit për Menaxhimin e Financave dhe Kontrollit për vitin 2025, nxjerr:

V E N D I M

1. **THEMELOHET:** Grupi punues për plotësimin e Pyetësorit të Vetë Vlerësimit për Menaxhimin e Financave dhe Kontrollit për vitin 2025 dhe në grupin punues caktohen:

1.1. Ilir Ferati, Kryetar i Komunës, Kryesues i Grupit punues,
1.2. Agim Ademaj, Shef i Kabinetit të Kryetarit, anëtar,
1.3. Genc Ademaj , Nënkryetar i Komunës, anëtar,
1.4. Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtorisë Komunale për Arsim, anëtar,
1.5. Abedin Kabashi, Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, anëtar,
1.6. Xhevat Demaj, Drejtor i Drejtorisë për Emergjenca, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar,
1.7. Fisnik Shoshaj, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi, anëtar,
1.8. Kushtrim Buleshkaj Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis, anëtar,
1.9. Agon Dreshaj, Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar,
1.10. Dukagjin Hoxhaj, Drejtor i Drejtorisë për Inspeksion, anëtar,
1.11. Era Rexhaj, Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare,
1.12. Artan Gegaj, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, anëtar,
1.13. Driton Alihajdaraj, Drejtor i Drejtorisë për Administratë Komunale, anëtar,
1.14. Merita Bytyçi, Drejtoreshë e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, anëtare,
1.15. Qendrim Ibrahimaj, Zyrtar Kryesor Financiar, anëtar,
1.16. Rasim Mahmutovic, Udhëheqës i Sektorit për Komunitete dhe Kthim, anëtar.

2. Grupi punues i lartcekur obligohet që punës t`ia filloj menjëherë për plotësimin e Pyetësorit të Vetë Vlerësimit për Menaxhimin e Financave dhe Kontrollit për vitin 2025.

3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Grupi Punues.

4. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Grupit Punues,
-Arkivi i zyrës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 243/2026
Data: 13.03.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Kryetari i Komunës bazuar në Nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në Nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010, për themelimin e Komisionit permanent për verifikimin dhe pranimin e projekteve sipas kontratës: "Hartimi i projekteve infrastrukturore "; dhe nxjerr:

V E N D I M

1. **THEMELOHET:** Komisioni permanent për verifikimin dhe pranimin e projekteve sipas kontratës: "Hartimi i projekteve infrastrukturore", me numër prokurimi 633-25-2147-2-1-1/C993, dhe në komision caktohen:

   1.1. **Hekuran Rugova,** Kryesues i Komisionit
   1.2. **Blerim Bujupi,** anëtar;
   1.3. **Alban Llapaj,** anëtar;

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë verifikimin dhe pranimin e këtyre projekteve infrastrukturore : "Hartimi i projekteve infrastrukturore",Caktimi i keti komisioni bëhet për te siguruar kontrollin profesional verifikimit teknik sipas kontratës, si dhe do të kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtaret e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtaret e komisionit verifikues marrin përgjegjësi të plotë individuale për verifikimin e punimeve, sipas nenit 39 të Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni.

7. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Komisionit,
-Prokurimit,
-Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim,
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Kryetari Komunës
z.Hir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr. 242/2026
Data: 13.03.2026

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në Nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në nenin 70 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe ne fuqi nga data 01.11.2022 dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimi Publik, në fuqi nga data 11.11.2024, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.17/2026 të datës 12.03.2026 për plotësim ndryshim te Vendimit Nr.Br.01-293/2024 të datës 20.05.2024 të parashtruar nga Prokurimi, për Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të Menaxherit të kontratës për projektin: "Betonim i kanalit të Ujitjes dega e terezisë dhe segmenti i 4 i kanalit të Gogës -projekt dy vjeçar", nxjerr:

V E N D I M

1. CAKTOHET: Menaxheri i kontratës **Kompania Mbikëqyrëse PMN.Sh.p.k** , për projektin "Betonim i kanalit të Ujitjes dega e terezisë dhe segmenti i 4 i kanalit të Gogës -projekt dy vjeçar", me numër të jashtëm prokurimi 633-024-4086-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-024-017-521 dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës **CAKTOHET: Artan Gegaj**, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, për projektin, për kontratën lidhur në mes të Menaxherit të Prokurimit dhe fituesve të tenderit.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe në fuqi nga data 01.11.2022.

3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr: Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Kompania Mbikëqyrëse PMN.Sh.p.k,Menagjer i kontratës
-Artan Gegaj, Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të Menaxherit të kontratës
-Arkivi i zyrës së Kryetarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E ISTOGUT * OPŠTINA ISTOK * REPUBLIKA KOSOVO

Kryetari Komunës-ZKA
z.Hir FERATI

Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr. 241/2026
Data: 13.03.2026

Kryetari i Komunës, bazuar në Nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në Nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në nenin 70 të A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe ne fuqi nga data 01.11.2022 dhe Rregullores Nr.002/2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimi Publik, në fuqi nga data 11.11.2024, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.17/2026 të datës 12.03.2026 për plotësim ndryshim te Vendimit Nr.Br.01-867/2025 të datës 26.08.2025 të parashtruar nga Prokurimi, për Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të Menaxherit të kontratës për projektin: "Rehabilitim i kanalit të Gogës nga Penda deri ne Gurra koc-projekt dy vjeçar", nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** Menaxheri i kontratës **Kompania Mbikëqyrëse PMN.Sh.p.k**, për projektin "Rehabilitim i kanalit të Gogës nga Penda deri ne Gurrakoc-projekt dy vjeçar ", me numër të jashtëm prokurimi 633-025-7101-5-1-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-025-037R-511 dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës **CAKTOHET: Artan Gegaj** Drejtor Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural,, për kontratën lidhur në mes të Menaxherit të Prokurimit dhe fituesve të tenderit.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar A01Rregullës Nr.001/2022 për Prokurimin Publik i miratuar me datën 20.10.2022 nga KRPP-ja dhe në fuqi nga data 01.11.2022.

3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr: Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Prokurimit,
- Kompania Mbikëqyrëse PMN.Sh.p.k
-Artan Gegaj,
-Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Kryetari Komunës-ZKA
z.Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr. 240/2026
Data: 13.03.2026

Kryetari i Komunës, në pajtim me Nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), ne Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011) i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-92 dhe në pajtim me Nenin 19 paragrafi 19.16 të Rregulloren Nr.002/2024 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, shqyrtoj kërkesën të datës 11.03.2026 të parashtruar nga Drejtoria për shërbime Publike, për emërimin e një zyrtari nga Njësia Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike/Termat e Referencës për aktivitetin e Prokurimit për projektin: **1."Sanimi i Gjendjeve Emergjente dhe riparim i rrugëve Lokalet të rendit IV,V,VI" 2."Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal "3."Mirëmbajtja e Parkut të Qytetit në Istog"** për nevoja të Institucioneve Komunale, nxjerr:

V E N D I M

1. Emërohet: Naser Gjoci, Udhëheqës i Sektorit për shërbime Publike në Istog, , për emërimin e një zyrtari nga Njësia Kërkuese për hartimin e specifikimeve teknike/Termat e Referencës për aktivitetin e Prokurimit për projektin: **1."Sanimi i Gjendjeve Emergjente dhe riparim i rrugëve Lokalet të rendit IV,V,VI" 2."Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal "3."Mirëmbajtja e Parkut të Qytetit në Istog"** për nevoja të Institucioneve Komunale.

2. Zyrtari i lartëcekur obligohet ti hartoj Specifikimet teknike, të plotësoj dhe dorëzoj Deklaratën nen Betim duke përdorur formularin standard të aprovuar nga KRPP-ja sipas paragrafit 19.16 të Nenit 19 të Rregulloren Nr.002/2024 për Plotësim Ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Naser Gjoci.

4. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:
-Naser Gjoci,
- Drejtoria për shërbime Publike.
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOK
REPUBLIKA KOSOVO

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

Republika e Kosovës-Komuna e Istogut
Republika Kosovo-Opština Istok
Republic of Kosova-Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr. 239/2026
Data: 13.03.2026

Kryetari i Komunës, në pajtim me Nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), Nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 ne Nenin 1 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Rregulloren për Ndarjen e Subvencioneve 001Nr.146/2025. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave në Drejtorinë për Administratë Komunale, shqyrtoj kërkesën 02 Nr.400-6636 të datës 03.03.2026 të parashtruar nga Lumdita Idrizaj, Drejtoreshë e OJQ "HANDIKOS" zyra në Istog, për përkrahje financiare dhe me procesverbal 02 Nr.10/2026 të datës 03.03.2025, i propozon Kryetarit, të nxjerr:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa 02Nr.400-6636 e datës 03.03.2026 e parashtruar nga Lumdita Idrizaj, Drejtoreshë e OJQ "HANDIKOS" zyra në Istog, për përkrahje financiare për organizimin e tryezës ne kuadër te shënimit te 21 Marsit "Ditës Ndërkombëtare te Personave me Sindrimin Down" dhe me propozim të Komisioni i ndahen mjete financiare në shumë prej pesëqind euro **500.00€** nën programi buxhetor i barazisë gjinore, nga programi buxhetor i Administratës kategoria e shpenzimeve subvencion dhe transfere.

2. Mjetet e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e OJQ-së "Handikos" në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive.

3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Administratë Komunale.

4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi nuk lejohet ankesa. Palës së pakënaqur i lejohet të hapë konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje Administrative, brenda një afati prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
-Lumdita Idrizaj, OJQ"HANDIKOS",
-Drejtorisë për Administratë Komunale dhe
-Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republic of Kosova - Republika Kosova
Komuna e Istog
Municipality Istog - Opština Istok

KRYETARI | MAYOR | PRESEDNIK

01 Nr. 238/2026
Datë: 13.03.2026

Kryetari i Komunës së Istogut, bazuar në nenin 13 dhe nenin 58, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), në nenet 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016), në nenin 68 paragrafi 1 pika 2 të Statutit të Komunës së Istogut Nr. 01-62/10, të miratuar më 30.11.2010, si dhe në nenin 4 paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 1.5 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 146/2025, të miratuar më 31.07.2025, **pasi Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të nënave lehona në Zyrën e Kryetarit** shqyrtoi kërkesën 01-Nr.400-7757, të datës 12.03.2026, të parashtruar nga Fatime Cufa, me numër personal të letërnjoftimit 1233260262, nga fshati Llukac i Thatë, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare me rastin e lindjes së fëmijës, dhe duke u bazuar në procesverbalin e datës 16.03.2026, i propozon Kryetarit të Komunës të nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa 01-Nr.400-7262, e datës 06.03.2026, e parashtruar nga Fatime Cufa, me numër personal të letërnjoftimit 1233260262, për përkrahje financiare me rastin e lindjes së fëmijës. Në bazë të propozimit të Komisionit, palës i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere, nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë e menjëhershme.

2. Mjetet financiare të miratuara në pikën 1 të këtij vendimi do të transferohen në xhirollogarinë bankare të Fatime Cufa, në pajtim me procedurat e përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës, ndërsa për zbatimin e tij do të kujdeset Zyra e Kryetarit.

4. Ky vendim është përfundimtar në procedurë administrative.

KËSHILLA JURIDIKE
Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- *Fatime Cufa;*
- *Zyrës së Kryetarit dhe*
- *Arkivit të Zyrës së Kryetarit*

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E ISTOGUT
MUNICIPALITY ISTOG
OPŠTINA ISTOK

KRYETARI | MAYOR | PRESEDNIK

01 Nr. 237/2026
Datë: 13.03.2026

Kryetari i Komunës së Istogut, bazuar në nenin 13 dhe nenin 58, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), në nenet 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016), në nenin 68 paragrafi 1 pika 2 të Statutit të Komunës së Istogut Nr. 01-62/10, të miratuar më 30.11.2010, si dhe në nenin 4 paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 1.5 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 146/2025, të miratuar më 31.07.2025, **pasi Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të nënave lehona në Zyrën e Kryetarit** shqyrtoi kërkesën 01-Nr.400- 7666, të datës 12.03.2026, të parashtruar nga Blerta Ahmetxhekaj - Gashi, me numër personal të letërnjoftimit 1243595882 nga Istogu, për përkrahje financiare me rastin e lindjes së fëmijës, dhe duke u bazuar në procesverbalin e datës 16.03.2026, i propozon Kryetarit të Komunës të nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. MIRATOHET kërkesa 01-Nr.400-7666, e datës 12.03.2026, e parashtruar nga Blerta Ahmetxhekaj - Gashi, me numër personal të letërnjoftimit 1243595882 nga Istogu, për përkrahje financiare me rastin e lindjes së fëmijës. Në bazë të propozimit të Komisionit, palës i ndahen mjete financiare në shumë prej 150.00 € (njëqind e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere, nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë e menjëhershme.

2. Mjetet financiare të miratuara në pikën 1 të këtij vendimi do të transferohen në xhirollogarinë bankare të Blerta Ahmetxhekaj, në pajtim me procedurat e përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës, ndërsa për zbatimin e tij do të kujdeset Zyra e Kryetarit.

4. Ky vendim është përfundimtar në procedurë administrative.

KËSHILLA JURIDIKE
Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- *Blerta Ahmetxhekaj - Gashi;*
- *Zyres së Kryetarit dhe*
- *Arkivit të Zyrës së Kryetarit*

REPUBLIKA E KOSOVË
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOG
REPUBLIKA KOSOVO

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr. 236/2026
Datë: 13.03.2026

Kryetari i Komunës së Istogut, bazuar në nenin 13 dhe nenin 58, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), në nenet 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016), në nenin 68 paragrafi 1 pika 2 të Statutit të Komunës së Istogut Nr. 01-62/10, të miratuar më 30.11.2010, si dhe në nenin 4 paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 1.5 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 146/2025, të miratuar më 31.07.2025, **pasi Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të nënave lehona në Zyrën e Kryetarit** shqyrtoi kërkesën 01-Nr.400-7599, të datës 11.03.2026, të parashtruar nga Ardita Kuqi, me numër personal të letërnjoftimit 1232911871, nga Istogu i Poshtëm, për përkrahje financiare me rastin e lindjes së fëmijës, dhe duke u bazuar në procesverbalin e datës 16.03.2026, i propozon Kryetarit të Komunës të nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. MIRATOHET kërkesa 01-Nr.400-7599, e datës 11.03.2026, e parashtruar nga Ardita Kuqi, me numër personal të letërnjoftimit 1232911871, për përkrahje financiare me rastin e lindjes së fëmijës. Në bazë të propozimit të Komisionit, palës i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere, nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë e menjëhershme.

2. Mjetet financiare të miratuara në pikën 1 të këtij vendimi do të transferohen në xhirollogarinë bankare të Ardita Kuqi, në pajtim me procedurat e përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës, ndërsa për zbatimin e tij do të kujdeset Zyra e Kryetarit.

4. Ky vendim është përfundimtar në procedurë administrative.

KËSHILLA JURIDIKE
Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Ardita Kuqi;
- Zyres së Kryetarit dhe
- Arkivit të Zyrës së Kryetarit

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

01 Nr. 235/2026
Datë: 13.03.2026

Kryetari i Komunës së Istogut, bazuar në nenin 13 dhe nenin 58, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), në nenet 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016), në nenin 68 paragrafi 1 pika 2 të Statutit të Komunës së Istogut Nr. 01-62/10, të miratuar më 30.11.2010, si dhe në nenin 4 paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 1.5 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 146/2025, të miratuar më 31.07.2025, **pasi Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të nënave lehona në Zyrën e Kryetarit** shqyrtoi kërkesën 01-Nr.400-7262, të datës 06.03.2026, të parashtruar nga Fatjetë Brahimaj, me numër personal të letërnjoftimit 1245109446, nga fshati Llukac i Begut, Komuna e Istogut, për përkrahje financiare me rastin e lindjes së fëmijës, dhe duke u bazuar në procesverbalin e datës 10.03.2026, i propozon Kryetarit të Komunës të nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. MIRATOHET kërkesa 01-Nr.400-7262, e datës 06.03.2026, e parashtruar nga Fatjetë Brahimaj, me numër personal të letërnjoftimit 1245109446, për përkrahje financiare me rastin e lindjes së fëmijës. Në bazë të propozimit të Komisionit, palës i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere, nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë e menjëhershme.

2. Mjetet financiare të miratuara në pikën 1 të këtij vendimi do të transferohen në xhirollogarinë bankare të Fajtetë Brahimaj, në pajtim me procedurat e përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës, ndërsa për zbatimin e tij do të kujdeset Zyra e Kryetarit.

4. Ky vendim është përfundimtar në procedurë administrative.

KËSHILLA JURIDIKE
Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- *Fatjetë Brahimaj;*
- *Zyres së Kryetarit dhe*
- *Arkivit të Zyrës së Kryetarit*

Kryetari i Komunës
Z. Ilir FERATI

01 Nr. 234/2026
Datë: 13.03.2026

Kryetari i Komunës së Istogut, bazuar në nenin 13 dhe nenin 58, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), në nenet 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016), në nenin 68 paragrafi 1 pika 2 të Statutit të Komunës së Istogut Nr. 01-62/10, të miratuar më 30.11.2010, si dhe në nenin 4 paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 1.5 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 146/2025, të miratuar më 31.07.2025, **pasi Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të nënave lehona në Zyrën e Kryetarit** shqyrtoi kërkesën 01-Nr.400 - 6842, të datës 04.03.2026, të parashtruar nga Floriana Maxharraj, me numër personal të letërnjoftimit 1235066234 nga Istogu, për përkrahje financiare me rastin e lindjes së fëmijës, dhe duke u bazuar në procesverbalin e datës 10.03.2026, i propozon Kryetarit të Komunës të nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa 01-Nr.400 - 6842, e datës 04.03.2026, e parashtruar nga Floriana Maxharraj, me numër personal të letërnjoftimit 1235066234, për përkrahje financiare me rastin e lindjes së fëmijës. Në bazë të propozimit të Komisionit, palës i ndahen mjete financiare në shumë prej 150.00 € (njëqind e pesëdhjetë euro) nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere, nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, si ndihmë e menjëhershme.

2. Mjetet financiare të miratuara në pikën 1 të këtij vendimi do të transferohen në xhirollogarinë bankare të Floriana Maxharraj, në pajtim me procedurat e përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës, ndërsa për zbatimin e tij do të kujdeset Zyra e Kryetarit.

4. Ky vendim është përfundimtar në procedurë administrative.

KËSHILLA JURIDIKE
Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- *Floriana Maxharraj;*
- *Zyres së Kryetarit dhe*
- *Arkivit të Zyrës së Kryetarit*

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

01 Nr. 233/2026
Data: 13.03.2026

http://kk.rks-gov.net/istog/

Bazuar në bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 50 të Statutit të Komunës së Istogut dhe nenit 2, paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në komuna, Kryetari i Komunës së Istogut, vendosi si më poshtë, dhe nxjerr:

V E N D I M

1. z. Meriton Ferati i identifikuar me numër personal 1234546160 emërohet në pozitën Zyrtar për Logjistikë – Shofer, në kuadër të stafit mbështetës të Kryetarit të Komunës së Istogut.

2. Statusi i pozitës Pozita e mësipërme është pozitë e stafit mbështetës të Kryetarit të Komunës dhe marrëdhënia e punës e të emëruarit zgjat për kohë sa zgjat mandati i Kryetarit të Komunës.

3. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të përcjellë Vendimin tek Divizioni i Pagesave në Ministrinë e Financave për vendosje në listën e pagave dhe mëditjeve.

5. Ky vendim ka karakter organizativ për funksionimin e Kabinetit të Kryetarit të Komunës.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për buxhet dhe financa-Zyrtarja Financiare për Paga Mëditje dhe Kompensime.

Vendimi i dërgohet:
- Meriton Ferati,
-Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe
-Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Kryetari Komunës
z.Ilir FERATI

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova

Komuna Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Kryetari / Predsednik / Mayor

http://kk.rks-gov.net/istog/

01 Nr. 232/2026
Data: 13.03.2026

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), bazuar në nenin 68 paragrafi 1, pika1.1, nenin 69, paragrafi 1, 1.2, nenit 86 pika 2 e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.21/2023), nenin 13 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L197 për Zyrtaret Publik, nenit 5,paragrafi 1, pika 1.2, nënpika 1.2.4 të Rregullores (QRK) Nr.28/2024 Për Pezullimin nga Marrëdhënia e Punës, shqyrtoj kërkesën 01-016-1968 të datës 16.01.2026 të parashtruar nga Arta Balaj, për pezullimin e marrëdhënies së punës së Mësimdhënëses së Gjuhës Angleze në SHFMU "Fan S.Noli " në Llukac të Begut me plotësim norme në IP "Gëzimi Ynë" në Istog, dhe nxjerr:

V E N D I M

Për pezullim të marrëdhënies së punës sipas detyrës zyrtare

1. MIRATOHET: kërkesa 01-016-1968 e datës 16.01.2026, e parashtruar nga Arta Balaj Mësimdhënëse e Gjuhës Angleze në SHFMU "Fan S.Noli " në Llukac të Begut me plotësim norme në IP "Gëzimi Ynë" në Istog, për pezullim të marrëdhënies së punës pa pagesë, për shkak të zgjedhjes së saj si anëtare e Kuvendit të Komunës së Istogut nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

